

THIRRJE PËR APLIKIM PËR POZICIONET VAKANTE NË KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE TREGTARE SHETËTËRORE

Bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 03.10.2018 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Tregtare Shetëtare”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, Urdhërit të Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 133, datë 26.09.2025 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive tregtare strategjike dhe jostrategjike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, Urdhrit nr. 5, datë 12.01.2026 “Për hapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionet vakante në këshillat Mbikëqyrës”, Ministria shpall vendet vakante në Këshillat Mbikëqyrës, ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përfaqësuese e pronarit shetëtar apo ministri e linjës, si më poshtë:

- “Albgaz” sh.a, 1 (një) vend;
- “OSHEE” sh.a, 3(tre) vende;
- “OST” sh.a, 2(dy) vende;
- “KESH” sh.a, 1(një) vend;
- “Albpetrol” sh.a, 3 (tre) vende;
- “EKORR” sh.a, 2 (dy) vende;
- “Albkrom” sh.a, 1 (një) vend;
- “Rregjistri Detar Durrës” sh.a, 1 (një) vend;
- “Albminiera” sh.a, 1 (një) vend

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shetëtar shqiptar;
- b) të zotërojë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- d) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- e) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;
- ë) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- f) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

Kandidati që aplikon për anëtar në Këshillin Mbikëqyrës, në përmbushje të kriterëve ligjore, paraqet pranë Ministrisë dokumentacionin si vijon:

- kopje të dokumentit të identifikimit;
- jetëshkrimin;
- kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vjet akademikë;

- vërtetim që për të nuk është marrë masë disiplinore për largim nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- kopje të librezës së punës të njehsuar me origjinalin;
- dëshmi penaliteti (në rast të mos sigurimit të saj në kohë të depozitohet dokumentacion provues që është aplikuar për marrjen e këtij dokumenti);
- vërtetim mjekësor që është i aftë për punë (në rast mos sigurimit në kohë të depozitohet dokumentacion provues që është aplikuar për marrjen e këtij dokumenti);
- vetëdeklarim se nuk gjendet në konflikt interesi me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, bëhet në zyrën e Arkiv-Protokollit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nga data **19.01.2026-23.01.2026**.

Përzgjedhja e kandidatit për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në dy faza.

Faza e parë: Verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga Kandidatët, e cila realizohet nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Nëse struktura përgjegjëse për burimet njerëzore konstaton se dokumentacioni i paraqitur ka mangësi, e njofton kandidatin në rrugë elektronike për plotësimin e tyre brenda një afati prej 2 (dy) ditë-pune. Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore harton listën me kandidatët që plotësojnë kërkesat ligjore dhe ia përcjellë atë Ministrit.

Faza e dytë: Ministri përzgjedh kandidatët fitues nga lista e paraqitur nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore.

Komunikimi me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresës së e-mail.